

VENDIM
Nr. 5944, datë 30.10.2018

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”*, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 6 datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“Elida-2017” sh.p.k.**, protokolluar me nr. 1871 prot., datë 26.4.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 5, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, i ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 6, datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 1.500.000 lekë, pezullimin plotësisht të aktivitetit dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Elida-2017” sh.p.k. ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.